# 3 Bashkim familjar tek i huaji me leje qëndrim leje qëndrim B, C ose F.

**Qëllimi:** Për personat të cilët janë të kurorëzuar me shtetas të huaj me leje qëndrimi dhe dëshirojnë të jetojnë tek bashkëshorti/ bashkëshortja në Zvicër.

**Ju lusim të mos vonoheni në ditën e terminit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni termin të ri.**

**DOKUMENTET E NEVOJSHME**

| | |
|---|---|
| ☐ 3 formularë të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte. | ☐ Certifikata familjare origjinale. |
| ☐ Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit (pasaporta) si dhe 2 kopje. | ☐ Certifikata personale origjinale.* |
| ☐ 2 kopje të pasaportës së bashkëshortit/-es në Zvicër si dhe 2 kopje e leje qëndrimit të tij /saj. | ☐ Në rast të ndryshimit të emrit: Kopje e vërtetuar e procesverbalit të ndryshimit të emrit/mbiemrit. |
| ☐ Certifikata e lindjes origjinale: lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja. | ☐ Kurorëzimi i/e të miturve (nën 18 vjeç): Vendimi i gjyqit për lejimin e martesës. * |
| ☐ Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër. | ☐ Vërtetim i Gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë.* |

☐ Certifikata e martesës origjinale lëshuar nga autoriteti kompetent në shtetin ku është lidhur kurora me gjendjen civile para kurorëzimit:

- **I/e divorcuar:**
  Fletë shkurorëzimi dhe dokumenti origjinal i gjendjes civile në të cilin përmendet shkurorëzimi.
- **I/e ve:**
  Certifikata e vdekjes e bashkëshortit/-es paraprak/-e.

**INFORMATA TË RENDËSISHME:**

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- * Të gjitha vendimet të cilat janë në gjuhë lokale të Kosovës duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Personi i cili jeton në Zvicër duhet të informohet drejtpërsëdrejti me zyrën kompetente të migracionit për ecurinë e procedurës.
- Formularët si dhe informatat mund të merren falas nga Ambasada e Zvicrës.
- Ambasada nuk mund të përgjigjet në pyetjet në lidhje me statusin e dosjes në Zvicër.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Terminët caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka terminë me prioritet).
- Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet ne ambasadë përmes e-mail, postes, ose fax-it.
- Ju duhet t`i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar termini.
- Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.

## Si caktohet termini ?

- **Caktimi i terminit:** Ju lusim ta kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar termin: pristina.visa@eda.admin.ch. Ju lutëm të bashkëngjitni **një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të personit që dëshiron të bëjë kërkesë për bashkim familjar.**

- **Marrja e vendimit:** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente në Zvicër. Bashkëshorti/ja/prindi në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lusim që të vini me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të **hënës deri të premten prej orës 8:00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.**

## Vula apostile

Të gjitha dokumentet shqiptare duhet të jenë te pajisur me vulën apostile nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

## Pagesa

80€ për të rritur

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rastit: Pagesë shtesë administrate.
- Paratë e pagesës nuk kthehen (edhe në rast se viza refuzohet).
- Tarifat mund të ndryshojnë pa paralajmërim.

## Kujdes nga agjencitë

Personat që ofrojnë shërbimet e tyre jashtë rrethojave të zeza nuk kanë asnjë lidhje me ambasadën. Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me ndonjë agjenci dhe stafi i ambasadës zvicerane nuk ka asnjë kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.

---

Keni parasysh se Ambasada Zvicerane ka të drejt:

- të kërkojë dokumente shtesë.
- ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
- t`i thërrasë aplikuesit në bisedë ose intervistë.
- ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.